



**PËRMBAJTJA:**

	<b>FAQE</b>
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 14

**"Geoalbania Uno" shpk**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

*(Vlerat janë në Lek)*

**Pasqyra e Pozicionit Financiar**  
**më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
<b>AKTIVET</b>			
<b>Aktive afatshkurtra</b>			
Të tjera llogari të arkëtueshme	4	7,588,833	7,459,065
<b>Total aktive afatshkurtra</b>		<b>7,588,833</b>	<b>7,459,065</b>
<b>Aktivitet afatgjata</b>			
Aktive afatgjata materiale	5	38,885,613	38,885,613
<b>Total aktive afatgjata</b>		<b>38,885,613</b>	<b>38,885,613</b>
<b>Total aktive</b>		<b>46,474,446</b>	<b>46,344,678</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrime afatshkurtra</b>			
Llogari të pagueshme tregtare	6	1,960,938	2,170,960
Detyrime tatimore	7	8,371	8,371
Të tjera detyrime	8	26,010	59,990
<b>Total detyrime afatshkurtra</b>		<b>1,995,319</b>	<b>2,239,321</b>
<b>Detyrime afatgjata</b>			
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	9	45,734,979	45,015,452
<b>Total detyrime afatgjata</b>		<b>45,734,979</b>	<b>45,015,452</b>
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>47,730,298</b>	<b>47,254,773</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali i nënshkruar	10	100,000	100,000
Rezerva të tjera		(1,010,095)	(1,010,095)
Fitimi i ushtrimit		(345,757)	-
<b>Total kapitali</b>		<b>(1,255,852)</b>	<b>(910,095)</b>
<b>Totali i kapitalit dhe detyrimeve</b>		<b>46,474,446</b>	<b>46,344,678</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**“Geoalbania Uno” shpk**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

*(Vlerat janë në Lek)*

**Pasqyra e Performancës**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	11	114,230	-
			-
<b>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</b>		<b>(716,340)</b>	-
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-	-
2) Të tjera shpenzime	12	(716,340)	-
			-
<b>Shpenzime të personelit</b>	<b>13</b>	<b>(100,440)</b>	-
1) Paga dhe shpërblime		(40,320)	-
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(60,120)	-
			-
<b>Shpenzime financiare</b>		<b>356,793</b>	-
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		-	-
2) Shpenzime/(të ardhura) të tjera financiare neto	14	356,793	-
			-
<b>Fitimi/humbja para tatimit</b>		<b>(345,757)</b>	-
			-
<b>Shpenzimi i tatimit mbi fitimin</b>		-	-
<b>Fitimi/humbja e vitit</b>		<b>(345,757)</b>	-
			-
<b>Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin</b>		<b>(345,757)</b>	-

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"Geoalbania Uno" shpk  
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital  
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	100,000	(1,010,095)	-	(910,095)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	100,000	(1,010,095)	-	(910,095)
Fitimi / Humbja e vitit	-	-	(345,757)	(345,757)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100,000	(1,010,095)	(345,757)	(1,255,852)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori i Geoalbania Uno sh.p.k më 19.03.2018 dhe janë firmosur si më poshtë.



Massimo De Petro  
Administrator

Mazars Shpk

Mazars shpk

Hartuesi Pasqyrave Financiare



**“Geoalbania Uno” shpk**  
**Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

*(Vlerat janë në Lek)*

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare**  
**Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016
<b>Flukset e parasë nga aktivitetet operative</b>		
Fitim / Humbja e vitit	(345,757)	-
Shpenzimet financiare jomonetare	(471,023)	
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(129,768)	(132,443)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(244,002)	354,098
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit</b>	<b>(1,190,550)</b>	<b>221,655</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	-	(413,430)
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit</b>	<b>-</b>	<b>(413,430)</b>
<b>Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>		
Hua të arkëtuara	1,076,320	191,775
<b>Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit</b>	<b>1,076,320</b>	<b>191,775</b>
<b>Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare</b>	<b>(114,230)</b>	
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare	114,230	
<b>Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 14, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

## **1. Informacion i përgjithshëm**

Shoqëria "GEOALBANIA UNO" Shpk është regjistruar pranë QKR në 12/10/2010  
Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr. 7638 dt. 19 Nëntor 1992 "Për shoqëritë tregtare" si dhe nga statuti i saj.

"GEOALBANIA UNO" Shpk është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Kapitali i shoqërisë "GEOALBANIA" Shpk është 100,000 Leke, i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1,000 Leke secila,

"GEOALBANIA UNO" sh.p.k është një shoqëri e huaj me një ortak, GEOENERGIE S.P.A, zotërues të 100% të kuotave të kapitalit të shoqërisë.

Administrator i Shoqërisë është z. Massimo De Petro për periudhën nga 03/04/2017 deri në 17/11/2019.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga "Abdi Toptani", Torre Drin, Kati II, Tiranë, Shqipëri.  
Ajo është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me NIPT L02212002F.

Aktiviteti i shoqërisë është Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentraleve "Progonat -Lekdush dhe "Bence e Siperme" tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndërtimi, venia pune, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksortimi dhe shitja e energjisë elektrike sipas Kontrates së Koncesionit Nr.1638 Rep,Nr.424/2 Kol,date 26.03.2009 e lidhur ndërmjet paleve,"Radici Energie" s.p.a dhe Ministrisë së Ekonomisë,Tregëtisë dhe Energjitikës.

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**

### **2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe amenduar me urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhrë hyri në fuqi në fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

Kompania përdor formatin e publikuar nga NAS për prezantimin e pasqyrave financiare..

### **2.2. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

### **2.3. Biznesi në vijimësi**

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

### **2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes**

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime**

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në

## **2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**

### **2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)**

datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

#### **2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

#### **2.5.2. Provizionet**

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

## **3. Politikat Kontabël**

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

### **3.1. Transaksionet në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

<b>Kursi i këmbimit</b>	<b>2017</b>	<b>2016</b>
Euro/LEK	132.95	135.23
USD/ LEK	111.10	128.17



### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiarë**

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

##### *Mjetet monetare*

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

##### *Llogari të arkëtueshme*

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

##### *Llogari të pagueshme*

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

##### *Hua të marra dhe të dhëna*

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

##### *Vlera e drejtë*

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

##### *Të tjera*

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

*(Vlerat janë në Lek)*

### **3. Politikat kontabël (vazhdim)**

#### **3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)**

##### *Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

##### *Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

#### **3.3. Inventarët**

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

#### **3.4. Aktive afatgjata materiale**

##### *i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

##### *ii. Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*(Vlerat janë në Lek)*

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)**

##### *iii. Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Normat e amortizimit të aplikuara janë sipas kërkesave fiskale dhe nuk marrin në konsideratë vlerësimin e amortizimit sipas jetes së dobishme të aktivitetit.

##### *iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

#### **3.5. Të ardhurat**

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

#### **3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit**

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

#### **3.7. Qiratë**

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

#### **3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

#### **3.9. Tatimi mbi fitimin**

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

### **3. Politikat Kontabël (vazhdim)**

#### **3.9 Tatimi mbi fitimin (vazhdim)**

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t’u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t’u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatuueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

#### **3.9. Fondet për pensione**

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

#### **3.10. Transaksionet me palët e lidhura**

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

#### **3.11. Provizionet**

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

#### **3.12. Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara**

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes

**“Geoalbania Uno” shpk**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

*(Vlerat janë në Lek)*

**4. Të tjera llogari të arkëtueshme**

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
TVSH e kreditueshme	7,588,833	7,459,065
	<u><b>7,588,833</b></u>	<u><b>7,459,065</b></u>

**5. Aktivet afatgjata materiale**

Shoqëria është në fazë investimi. Gjithë kostot e periudhës janë kapitalizuar në punimet në proces, të paraqitura si më poshtë:

	<u>Punime në proces</u>
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	38,885,613
Shtesa	-
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	<u><b>38,885,613</b></u>

**6. Llogari të pagueshme tregtare**

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Furnitorë vendas	1,960,938	2,170,960
	<u><b>1,960,938</b></u>	<u><b>2,170,960</b></u>

**7. Detyrime tatimore**

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	8,371	8,371
	<u><b>8,371</b></u>	<u><b>8,371</b></u>

**8. Të tjera detyrime**

Të tjera detyrime paraqesin detyrimet ndaj shoqërisë Mazars për financime afatshkurtra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 si më poshtë:

	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
Detyrim ndaj Mazars Shpk	26,010	59,990
	<u><b>26,010</b></u>	<u><b>59,990</b></u>

**“Geoalbania Uno” shpk**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

*(Vlerat janë në Lek)*

**9. Llogari të pagueshme nga palët e lidhura**

Të pagueshmet afatgjata ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<b>31 Dhjetor 2017</b>	<b>31 Dhjetor 2016</b>
Financim nga Geoenergie	45,734,979	45,015,452
	<b>45,734,979</b>	<b>45,015,452</b>

**10. Kapitali aksionar**

Kapitali i shoqërisë “Geoalbania Uno” Shpk është 100,000 Leke, i ndarë në 100 kuota me vlerë nominale 1,000 Lekë secila.

Gjatë vitit 2017 nuk ka pasur ndryshime në përbërjen dhe strukturën e kapitalit themeltar të shoqërisë.

**11. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit**

Të ardhura të tjera të shfrytëzimit më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016</b>
Fitime nga këmbimet valutore	114,230	-
	<b>114,230</b>	<b>-</b>

**12. Të tjera shpenzime**

Të tjera shpenzime më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016</b>
Shpenzime administrative dhe noteriale	5,400	-
Konsulenca ekonomike	643,840	-
Shpenzim për shërbime bankare	4,100	-
Taksa vendore	63,000	-
	<b>716,340</b>	<b>-</b>

**13. Shpenzime të personelit**

Shpenzime të personelit më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016</b>
Pagat e personelit te administratës	40,320	-
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore personeli i administratës	60,120	-
	<b>100,440</b>	<b>-</b>

**“Geoalbania Uno” shpk**  
**Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

*(Vlerat janë në Lek)*

**14. Shpenzime të tjera financiare**

Shpenzime të tjera financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017</b>	<b>Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2016</b>
Të ardhura nga këmbimet valutore	356,793	-
	<b>356,793</b>	<b>-</b>

**15. Angazhime dhe pasiguri**

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

**16. Ngjarje pas bilancit**

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

